



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 663/3 Prot.

Tiranë, më 18.03.2021

VENDIM

Nr. 16, datë 18.03.2021

**PËR
SHPËRBLIMIN E PUNËS TË KOMISIONEVE ZGJEDHORE, KIZ, KA, KZF,
KQV DHE PERSONELIT NDIHMËS, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË,
TIRANË**

Mëshetur në pika 3/c, pika 4/ç, të nenit 3, pika 1 e e nenit 108 të ligjit nr.80, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë", pika 18 e VKM-së nr.329, datë 12.01.2017 "Për statutin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik", shkresat e kryetares së KQZ-së nr.149 prot., datë 04.11.2020 dhe 149/1 prot., datë 11.12.2020 "Kërkesë për shpërblim financiar", shkresës nr.2911 prot., datë 18.12.2020 "Kërkesë për shpërblim financiar" të kryetares së komisionit të apelimit, shkresat nr.2991/2 prot, datë 13.01.2021 "Kthim përgjigje" dhe nr.2991/3 prot., datë 19.01.2021 "Në vijim të përgjigjes me nr. 2991/2 prot., datë 13.01.2021" si dhe në diskutimet e mbledhjes së datës 18.03.2021, Bordi Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë pagesën e anëtarëve të komisioneve zgjedhore, në vlerën 2,013,000 (dymilion e trembëdhjetë mijë) lekë e detajuar si më poshtë (listat bashkëlidhur):

- Komisioni Institucional Zgjedhor (KIZ) të shpërblehet për punën e kryer me shumën 60,000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë për çdo anëtar të komisionit zgjedhor.

-Komisionet zgjedhore të fakulteve (KZF) të shpërblehet për punën e kryer si më poshtë

- Kryetari i KZF-së 41,000 (dyzet e një mijë) lekë.

- Anëtarët e KZF-së 35,000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë

-Komisioni i Apelimit (KA) të shpërblehet për punën e kryer me shumën 60,000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë për çdo anëtar të komisionit zgjedhor.

-Komisioni i qendrës së votimit (KQV) të shpërblehet për punën e kryer me shumën 20,000 (njëzetë mijë) lekë për çdo anëtar.

2. Personeli ndihmës që ka asistuar dhe ndihmuar në procesin e zgjedhjeve të shpërblehet për punën e kryer në shumën 60,000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë për çdo person. Shuma totale 360,000 (treqind e gjashtëdhjetë mijë)lekë (lista bashkëlidhur).

3. Fondet e nevojshme në vlerën 2,373,000 (dy milion e treqind e shtatëdhjetë e tremijë) lekë të përballohen nga fondet e parashikuara në llogarinë 6029005-7, duke mos tejkaluar tavanin buxhetor të përllogaritur në buxhetin e vitit 2021.

4. Ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe Administratorët e Fakulteteve për marrjen e masave për të kryer pagesat për të gjithë anëtarët e komisioneve në njësitë përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
FLORIAN TOTI

